




REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. 2-D / DPK	Nr. Prot. 01-2099/2012
Nr. llog. 02	Date 13.06.2012
Nr. paqet	



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 06.06.2012, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr.AKK- 03-4787/11,për Zyrtarin e Lartë z.Veton Firzi, Sekretar i Përhershëm në Ministrin e Kulturës, Rinis dhe Sportit, për shkak se Zyrtari i Lartë ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të mundshëm të interesit është zhvilluar procedura e parapare sipas nenit 18.1 të ligjit Nr.04/L-051, Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Pas informatës se marre gjate kontrollit të formularit për deklarim të pasurisë, ka filluar shqyrtimi i lendes me numër protokolli AKK-03-4787/11, që për trajtim ka pasur Zyrtarin e Lartë, z.Veton Firzi, Sekretar i Përhershëm në Ministrin e Kulturës, Rinis dhe Sportit.

Gjate zhvillimit të procedurës dhe analizimit të gjendjes është konstatuar se zyrtari e lartë, gjatë kohës së ushtrimit të funksionit publik si, Sekretar i Përhershëm në Ministrin e Kulturës, Rinis dhe Sporti , ka qene i regjistruar ne Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve ARBK, si Pronar dhe person i autorizuar ne biznesin D.P.H. "Toto Kafce" Prishtinë, dhe ne biznesin tjetër D.P.H"X-Haus"Prizren, që sipas Ligjit për parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr.04/L-051, kjo situatë ka paraqitur konflikt të mundshëm të interesit, dhe mos pajtueshmëri ne ushtrimin e funksionit publik, andaj Agjencia kundër Korrupsionit me datën 02.03.2012, e ka njoftuar zyrtarin e Lartë me shkresën e parë se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejte në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet që posedon Agjencia.

Pas këtyre procedurave, z. Veton Firzi, pasi ka kontaktuar me zyrtaret e Agjencisë ka kërkuar të ballafaqohet me faktet që posedon Agjencia.

Me datën 01.04.2012 është mbajtur takimi me, z.Veton Firzi, në zyrat e MKRS, gjatë takimit, është biseduar për gjendjen dhe faktet që disponon Agjencia lidhur me konfliktin e mundshëm të interesit.

Zyrtari i Lartë, z.Veton Firzi, gjatë takimit është pajtuar për situatën mirëpo është arsyetuar se nuk ka qenë informuar për këtë, pasi që nuk e ka informuar as kushë që nga momenti i emërimit si Sekretar i Përhershëm në Ministrinë e Kulturës, Rinis dhe Sportit

Zyrtari i Lartë, z.Veton Firzi, pas pyetjeve që i kanë bërë zyrtarët e AKK-ë, është përgjigjur duke shpjeguar se bizneset private që i ka, ku është bashkë aksionarë, mendon se nuk ka asnjë lidhshmëri me funksionin publik, dhe nuk ka pas njohuri për këtë situatë që mundë të shkaktoj Konflikt të mundshëm të Interesit dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik.

Zyrtaret e AKK-së, e kanë njoftuar z.Firzi, për situatën e cila paraqet mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik të paraparë sipas ligjit Nr.04/L-051, Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

z.Veton Firzi, është zotuar se në afatin ligjor do të bëjë ndryshimet në këto biznese, dhe do të largohet nga funksioni menaxhues si person i autorizuar në biznes.

Me datën 24.05.2012, Zyrtari i lartë z. Veton Firzi, Sekretar i Përhershëm në Ministrinë e Kulturës, Rinis dhe Sportit, ka dërguar në Agjencinë kundër Korrupsionit dëshmitë e lëshuara nga ARBK-ja, ku shihet se z.Veton Firzi, nuk ka me pozitën e personit të autorizuar në bizneset D.P.H. "Toto Kafe" Prishtinë dhe D.P.H. "X-Haus" Prizren, por ka mbetur vetëm si bashkëpronarë.

Andaj në bazë të dëshmive dhe fakteve konstatohet se :

Zyrtari i lartë z.Veton Firzi, Sekretar i Përhershëm në Ministrinë e Kulturës, Rinis dhe Sportit, ka shmangur gjendjen e mundshme të Konfliktit të Interesit në të cilën ndodhej, pasi që nuk mbanë me pozitën e personit të Autorizuar në bizneset e lartë cekura. Kjo situatë ka paraqitur mos pajtueshmëri me funksionin publik si, Sekretar i Përhershëm në Ministrinë e Kulturës, Rinis dhe Sportit.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

